

Përmbajtja e këtij peticioni qe eshte botuar nga disa gazeta, mbetet aktuale edhe sot, për faktin se politika po ecën në rrugën e gabuar që e konsideron pronën e grabitur pronë të pushtetit dhe rjedhimisht i jep vetes të drejtën e vazhdimit të komandës politike mbi pronat që Shteti ka detyrim ti kthejë tek pronari i shpronësuar.

Demokracia dhe shteti i së drejtës fillon me kthimin e pronës tek i zoti, i shpronësuar nga diktatura, duke zbatuar Kushtetutën në fuqi dhe Konventat Ndërkombëtare.

PETICION

**Presidentit të Republikës së Shqipërisë zotit Rexhep Mejdani,
Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë zotit Skënder Gjinushi,
Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë zotit Pandeli Majko.
Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.**

Tiranë

Të nderuar Zotërinj,

Me ndjenjën e përgjegjësisë qytetare patriotike, Ju drejtohem i shqetësuar për gjëndjen e krijuar sot në Shqipëri, ku shteti shqiptar nuk po angazhohet për zbatimin e Kushtetutës dhe të Konventave Ndërkombëtare në fuqi, për “Të drejtat dhe liritë e njeriut” lidhur me pronën e trashëguar, të shpronësuar me dhunë nga regjimi i diktaturës.

Kushtetuta e sotme e Republikës së Shqipërisë i vë detyrë Kuvendit që të nxjerrë ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera gjatë regjimit komunist. Vonesa në zbatimin e kësaj norme kushtetuese është ndër faktorët kryesorë që po gërryjnë sot shoqërinë shqiptare, ku mungon paqja sociale dhe lulëzojnë krimi, korrupsioni, klanet dhe arbitrariteti në organet e shtetit dhe të drejtësisë, si rrjedhojë e mos respektimit të të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtës së pronës private të luajtshme e të paluajtshme.

Duke pasur parasysh se demokracia dhe shteti i së drejtës është shtet i drejtësisë, i paqes dhe i harmonisë sociale, prona private e grabitur me dhunë nga diktatura nuk mund dhe nuk duhet të trajtohet si kategori politike për fushata elektorale të partive siç po veprohet. Situata e sotme e mbrujtur me ideologji të urrejtjes e të luftës famëkeqe të klasave, vazhdon të nëpërkëmbë dhe të dëmtojë shtresat shoqërore, të cilat gjatë regjimit komunist në Shqipëri ishin padrejtësisht më të goditurat.

Ligjet e deritashme të periudhës së pluralizmit, që me mangësitë dhe shtrembërimet e tyre bënë të mundur pasurimin e disa individëve me pronat që shteti i diktaturës ua kish grabitur pronarëve të ligjshëm, duke i quajtur ato “prona të shtetit”, janë goditja

më të rëndë që iu bë dhe vazhdon t'i bëhet demokracisë së brishtë shqiptare. Këto ligje, të cilat bien ndesh me normat morale, me Kushtetutën dhe me Konventat Ndërkombëtare, janë pengesë për zhvillimin e demokracisë në Shqipëri.

Me qëllim që të ndreqen gabimet dhe të plotësohen mangësitë në legjislacion dhe të zbatohet Kushtetuta në fuqi, kërkojmë angazhimin tuaj që të veprohet me përparësi për: Kthimin e pronës private tek i zoti duke zbatuar pa vonesë dhe pa mëdyshje Kushtetutën. Deri në kthimin e pronës tek i zoti, të merren masa ligjore për pezullimin e veprimeve praktike të deritanishme për ato ligje dhe akte normative, që bëhen pengesë arbitrare për kthimin e pronës ose për kufizime e gjymtime të saj me artifice juridiko-formale. Shfuqizimin e dispozitave që përcaktojnë kthimin e pronës me kufizime, si dhe administrimin nga shteti dhe nga institucionet shtetërore akoma të pronave të ish-pronarëve me emërtimin "PRONE E SHTETIT" me qëllim që ajo tu caktohet individëve të tjerë (pa asnjë titull pronësie) në përdorim, me qira, ose sipas interesave klanore, duke i mohuar kështu të shpronësuarit, të drejtën e tij të ligjshme mbi pronën e vet, veprime këto që përbëjnë shkelje flagrante të Kushtetutës.

Të nderuar Zotërinj, problemi i zgjidhjes së pronësisë në Shqipëri, është shumë më i lehtë, nga sa e paraqesin politikanët, që synojnë të pasurohen ose të përfitojnë padrejtësisht. Zgjidhja e këtij problemi kyç për sistemin e demokracisë në Shqipëri bëhet vetëm me një angazhim serioz dhe vullnet të sinqertë nga ana e drejtuesve të shtetit shqiptar. Peticioni ynë është vazhdim i kërkesave të njëpasnjëshme të bëra nga forcat demokratike, që nga viti 1991, për të arritur me mjete demokratike vendosjen e demokracisë së vërtetë, realizimin e orientimit euroatlantik të Shqipërisë, stabilizimin e rendit dhe qetësisë.

Shprehim bindjen se Ju, së bashku me patriotë të tjerë me ndjenjë përgjegjësie qytetare, me shoqatat dhe forcat demokratike brenda e jashtë vendit, do të na mirëkuptoni dhe do të bashkoheni me shqetësimin tonë.

Tiranë 16.09.1999

Peticioni është nënshkruar nga:

1. Ylli Popa (Prof.Dr. Kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë)
2. Pandeli Çina (Prof. Dr. Kardiolog)
3. Farudin Hoxha (N/Kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë)
4. Andonaq Londo (Dekan i fakultetit të Ing. Mekanike)
5. Marenglen Spiro (Rektor i Universitetit të Tiranës)
6. Eduard Sulstarova (Sekretar Shkencor i Akademisë)
7. Afrim Karagozi
8. Agim Shehu (hartograf, As. Prof. dr.)
9. Shefqet Hoxha (Mesues i Popullit)
10. Sherif Delvina (Mesues i Popullit),
11. Ramadan Sokoli (Studiues i artit dhe kulturës popullore)
12. Anesti Kondili (Prof.dr., Dekan i Fakultetit të Mjeksisë, Tiranë)

13. Halil Sykja (Prof. dr. Fakulteti i Shkencave të Natyrës)
14. Pirro A. Totozani (Avokat)
15. Gëzim Boçari (As. Prof. Fakulteti i Mjeksisë)
16. Agim Shehu (shkrimtar)
17. Piro Papalilo (Dr. i Shkencave Filozofike)
18. Vasilika Hysi (Dekane e Fakultetit të Drejtësisë)
19. Zija Shkodra (Historian, Prof.dr.)
20. Bajram Preza (Prof. dr. Antar i Akademisë së Shkencave)
21. Sitki Bushati (ish pedagog i Fakultetit të Mjekësisë)
22. Shefqet Ndroqi (Prof. dr., Qytetar Nderi i Tiranës)
23. Emanuel Heba (Prof. dr.)
24. Mexhid Prençi (Kritik arti)
25. Shyqyri Muça (Pedagog i Fizikës UT)
26. Gjergj Zavalani (mjek)
27. Sezai Braho (Prof. dr. Fakulteti i Mjeksisë)
28. Spiro Qirko (Prof.dr. kardiolog)
29. Adelina Mazreku (mjekje onkologe)
30. Jahja Pulo (mjek infeksionist, gastrohepatolog, As. Prof.)
31. Xheladin Ceka (As. Prof., zv/Dekan i Fakultetit të Mjeksisë)
32. Kasem Biçoku (Dr. i shkencave, historian)
33. Flamur Tartari (Prof. dr. Antar i Akademisë Shkencave, New Jork)
34. Tom Nikolla (rapsod popullor)
35. Arben Puto (prof. dr. jurist)
36. Xhevahir Spahiu(poet, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve)
37. Fatos Arapi (shkrimtar)
38. Sopot Haçi (dr. i shkencave teknike)
39. Tafil Baçi (ish-futbollist i skuadrës kombëtare)
40. Vasillaq Kedhi (Prof. dr. Universiteti Tiranë)
41. Aleks Luarasi (Prof.dr. Konstitucionalist)
42. Rustem Gjata (ish kryetar i Gjykatës Kushtetuese)
43. Bardhyl Çipi (Prof. dr. Fakulteti i Mjeksisë)
44. Dëfrim Shkupi (Prof. Dr., President i Shoqatës së Gjeologëve dhe Gjeomjedisit, Antar i Akademisë Shkencave New Jork)
45. Tish Daia (Kompozitor, Atrist i Popullit, Antar i Akademisë Shkencave)
46. Asti Papa (Prof. dr.)
47. Miranda Gaçe (Drejtoreshë ekskluzive e Shoqatës për Kulturë Demokratike)
48. Petraq Sotiri (Prof. dr. Antar korespondent i Akademisë Vitikulturës dhe Verës, Siena –Itali)
49. Fatmir Frashëri (Mjeshtër i merituar i sportit)
50. Pirro Mani (Regjizor, Artist i Popullit)